

Në bazë të Vendimit të u.d. Kryeshefit Ekzekutiv, nr. 2236 të datës 05.11.2021 si dhe plotësim vendimi nr.2236/1 i datës 25.11.2021, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a. shpall:

K O N K U R S

për ndarjen e dhjetë (10) bursave për studentë për vitin akademik 2021/2022

Kushtet dhe kriteret

- I. Bursat do të ndahen për studentët e studimeve themelore (Bachelor) të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës, të cilët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 1. Të jenë studentë të rregullt të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
 2. Të jenë studentë të regjistruar në vitin të II-të ose të III-të;
 3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 4. Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku **7.50 (shtatë pikë pesëdhjetë)**, deri më datën 05.11.2021;
 5. Të kenë se paku 40 ECTS kredi studentët e regjistruar në vitin e dytë dhe 90 ECTS kredi studentët e regjistruar në vitin e tretë, deri më datën 05.11.2021;
 6. Metodologjia e vlerësimit për grumbullimin e pikëve sipas kriterëve në pikën 4 dhe 5 do të behët sipas llogaritjeve në shtojcën e bashkëngjitur me konkurs.
 7. Studentët të cilët kanë fituar ndonjë bursë tjetër nuk kanë të drejtë konkurrimi;
 8. Bursat do të ndahen për studentët e studimeve themelore (Bachelor) sipas drejtimeve:
 - Elektroenergjetikë (4 bursa),
 - Elektronikë (2 bursa),
 - Inxhinieri kompjuterike (2 bursa),
 - Telekomunikacion (1 bursë) dhe
 - Automatikë e Kompjuterizuar dhe Robotikë (1 bursë).

Kategoritë e studentëve me përparësi

- II. Kategoritë e studentëve që do të kenë përparësi për fitimin e bursës, në kushte të barabarta me studentët tjerë janë:
 1. Fëmijët e dëshmorëve të luftës së UÇK-së;
 2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 3. Veteranët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 4. Fëmijët e të zhdukurve të luftës;
 5. Fëmijët e familjeve që janë përfitues të skemave sociale;
 6. Fëmijët e ish të dënuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politik.
 7. Fëmijët të cilët janë më tepër se një student nga një familje.
 8. Studentët me aftësi të kufizuara

Dokumentacioni që kërkohet

- III. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e cekura me lartë duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. Fletëaplikacionin për bursë, i cili shkarkohet së bashku me konkursin nga ueb-faqet: www.kostt.com dhe <https://fiek.uni-pr.edu/>
2. Certifikatën e lindjes, origjinal
3. Vërtetimin për vitin e regjistruar akademik 2021/2022, duke cekur:
 - se është student i rregullt i vitit të dytë ose të tretë dhe,
 - se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve.
4. Certifikatën e vërtetuar të notave dhe kredive (ECTS) të akumuluarra për provimet e kryera deri më datën 05.11.2021 dhe notën mesatare;
5. Vërtetimin origjinal jo më i vjetër se 6 muaj, se i përket njëres prej kategorive të studentëve më përparësi sipas pikës II. të lëshuar nga institucionet kompetente;

Informata shtesë dhe forma e aplikimit

Lartësia e bursës do të jetë 100€ /muaj për vitin akademik 2021/2022 (gjithsej 12 muaj).

Gjatë përzgjedhjes së studentëve bursistë në përkrahje të barazisë gjinore, në kushte të barabarta përparësi ka gjinia pakicë.

Pas përzgjedhjes studentët bursistë do ta nënshkruajnë marrëveshjen me kompaninë KOSTT.

Të gjithë të interesuarit dokumentet e kompletuara bazuar në konkursin e shpallur duhet ti dorëzojnë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë adresa "Bregu i Diellit" nr.10 000 në zyrën 431 tek asistentja e Dekanit. DORËZIMI I DOKUMENTEVE PREJ ORËS 10:00 DERI NË ORA 15:00.

Dokumentet e pakompletuar dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen nga Komisioni.

Afati i aplikimit është 15 ditë nga data 26.11.2021 deri më datën 10.12.2021.

Lista e të gjithë aplikuesve dhe Vendimi mbi përzgjedhjen e studentëve bursistë do të publikohet jo më vonë se 30 ditë pas mbylljes së konkursit në ueb-faqen e KOSTT www.kostt.com dhe Universitetit të Prishtinës - FIEK-ut: <https://fiek.uni-pr.edu/>.

Kadri Kadriu
u.d.Kryeshf Ekzekutiv



Bashkëngjitur: Metodologjia e vlerësimit për grumbullimin e pikëve sipas kriterëve në pikën 4 dhe 5.

Metodologjia e vlerësimit për grumbullimin e pikëve.

Maksimum 100 pikë të fituara për meritën akademike të cilat ndahen në mënyrë të barabartë si në vijim:

- a. 50 pikë bazuar në kreditë ECTS të fituara deri më datën 05.11.2021, të llogaritura sipas formulës:

$$Piket(ECTS) = (ECTS_{Studentit} - ECTS_{Min}) \times \frac{50}{ECTS_{Max} - ECTS_{Min}}$$

Kriteret për kreditë ECTS:

- ECTS minimale për aplikim - për studentë që e kanë regjistruar vitin e dytë, 40 ECTS,
- ECTS minimale për aplikim - për studentë që e kanë regjistruar vitin e tretë, 90 ECTS,
- ECTS të studentit – ECTS të fituara nga studenti deri me datën 05.11.2021,
- ECTS maksimale – ECTS standarde të fituara pas përfundimit të vitit të parë(60 ECTS), përkatësisht pas përfundimit të vitit të dytë(120 ECTS).

- b. 50 pikë bazuar në Notën Mesatare (NM) të studentit deri më datën 05.11.2021, të llogaritura sipas formulës:

$$Piket(NM) = (NM_{Studentit} - Nota_{Min}) \times \frac{50}{10 - Nota_{Min}}$$

Kriteret për Notë Mesatare:

- Nota mesatare minimale për aplikim se paku 7.50,
- Nota Mesatare e studentit – nota e llogaritur si rezultat i notës mesatare për provimet e përfunduara deri më datën 05.11.2021.